



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1388/24 Datë: 12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin e Prishtinës për periudhën **tre (3) vjeçare** (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 1. *Shkenca e Materialeve MSc 120 me kuotën maksimumi 10 studentë për vit akademik;*
 2. *Kimi Ushqimore BSc 180 me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik.*
- II. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin e Prishtinës për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 3. *Biologji BSc 180 me kuotën maksimumi 45 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshimin e bartësve aprovet me vendim nga KSHC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Shkenca e Materialeve MSc 120 ECTS, A</i>	Avni Berisha Flamur Sopaj
2.	<i>Kimi Ushqimore BSc 180 ECTS, A</i>	Arben Haziri Bardha Korça Albert Maxhuni
3.	<i>Biologji BSc 180 ECTS, R</i>	Hazbije Sahiti Kimete Lluga Rizani Idriz Vehapi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Shkenca e Materialeve MSc 120 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Andriana Surleva dhe Juraj Bogat, është organizuar më 23.04.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht tre (3) dhe Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Kimi Ushqimore BSc 180 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Bruno Zelic dhe Juraj Bogat është organizuar më 23.04.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht tre (3), Substancialisht tre (3) dhe Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Biologji BSc 180 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Mladen Krajacic dhe Ervin Rems është organizuar më 24.05.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht një (1), Substancialisht pesë (5) dhe Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.

Për shkak se programet *Shkenca e Materialeve MSc 120 ECTS dhe Kimi Ushqimore BSc 180 ECTS*, janë akreditim për herë të parë KSHC ka vendosur që kohëzgjatja e akreditimit për këto programe të jetë tri (3) vite, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 2 të Nenit 35 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 124-të, të mbajtur më datë 25.05.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër si dhe dispozitave ligjore në fuqi përkatësisht paragrafit 1 të nenit 19 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin e Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.